



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
"BAJKAJ LAND" SH.A  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Nr.1342 prot.

VENDIM

Nr. 11 datë 25.06.2019

Vlorë, më 27.6.2019  
Vlorë, 03.7.2019

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë në mbledhjen e datës 17/08 2019, në mbështetje të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, statutit të shoqërisë "BajkajLand" sh.a, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga administratori i shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit:

- Kërkesën nr.1483 prot. dt. 21.08.2019 të Bashkisë Himarë,
- Kërkesën e paraqitur nga bashkia Himarë me Nr.1878 Prot. dt. 12.06.2018 ku kërkohet transferimi kapital i objektit "Stacioni i transferimit të mbetjeve" në Vumblo, Pilur,
- Përgjigjen e marrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë me shkresën me Nr.9900/1 Prot. dt. 24.09.2018 si rezultat i kërkesës sonë me Nr.28 Prot. dt. 11.07.2018 për interpretim se si duhet vepruar në kushtet kur kemi një kërkesë nga bashkia Himarë,
- Shkresën e ardhur nga Këshilli i Qarkut Vlorë me nr 281/1 prot datë 13.02.2019 ku kërkohet tu jepet vlerësim i kërkesës së bashkisë Himarë me nr 294 prot datë 31.01.2019 ku kërkohet tu jepet mundësia për ta përdorur Bashkia Himarë këtë stacion në format që bashkia ka paraqitur (kontratë emfiteoze, kontratë huapërdorje, kontratë dhurimi etj)

VENDOSI

- 1) Dhënie në përdorim bashkisë Himarë, të Stacionit të Transferimit në fshatin Vëmblo për një afat 1 vjeçar
- 2) Bashkia merr përsipër të mos i ndryshojë destinacionin objektit stacion transferimi dhe të mbikqyrë nga shoqëria Bajkaj Land.
- 3) Bashkia merr përsipër të gjitha detyrimet për energjinë elektrike, ujin e pijshëm, detyrimet ndaj të tretëve si në momentin që do i dorëzojë shoqërisë Stacionin e Transferimit.
- 4) Bashkia merr përsipër detyrimet e transportit për mbetjet nga pika e transferimit deri në Landfill dhe anasjelltas.
- 5) Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të përcjellë vendimin, të ndjekë procedurat ligjore dhe të lidhe marrëveshjen duke ju përmbajtur pikave të mësipërme.
- 6) Ky vendim hyn në fuqi sipas akteve ligjore në fuqi.

*Kryetar Këshillit Administrativ*

Konc. Vasil MARGA  
ADMINISTRATOR